



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR ERZEN

Nr. Serial: 000028

LEJE
PËR KRYERJE SHPIMI NËNTOKËSOR PËR NXJERRJE UJI (PUS- SHPIMI)

Nr. 17/ Prot., datë 25/10/2024

16 Miratuar me:

VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR ERZEN

Nr.8, datë 16/10/2024

Emri i individit/subjektit: "FUSHA" SH.P.K
I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/NIPT): J61922018S
Baseni Ujor: ERZEN
Qarku: TIRANË
Bashkia/ Njësia administrative: FARKË/TIRANË
Akuiferi (që kërkohet të shfrytëzohet) AKUIFERI NË SHKËMBINJ KOMPAKT ME
UJËMBAJTJE TË ULËT TË TORTONIANIT
Vendndodhja e Shpimit (Koordinatat KRGJSH):
X = 487485.3; Y= 4573149.2; Z=152 m.m.n.d;
Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: PËR UJITJE
Thellësia e parashikuar në metra: 160 m
Diametri 1 (m) 350 mm Thellësia nga 0.0 m në 5.0 m
Diametri 2 (m) 290 mm Thellësia nga 5.0 m në 160 m
Lloji i shpimit: ME PRESION
Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka): SIPAS KUSHTEVE TË LEJES
Periudha e vlefshmërisë: 5 VJET
Hyrja në fuqi: Pas publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve

KRYETARI

AFRIM QENDRO



Kushtet e posaçme të lejes për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus- shpimi)

1. Të realizojë shpimin dhe punimet e tjera hidrogeologjike duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me veprimtarinë;
3. Të instalojë, ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;
4. Të dorëzojë pranë AMBU-së, brenda 1 muaji nga hapja e pusit raportin hidrogeologjik, me konstatimet dhe konkluzionet përkatëse;
5. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
6. Kjo leje nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
7. Të respektojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit dhe të rrethojë sipas projektit brezat sanitarë të mbrojtjes.
8. Të mos dëmtojë brigjet dhe shtratin e burimit ujor;
9. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit;
10. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujor, ose në brigje në rast të një aksidenti, apo incidenti.
11. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujor në gjendjen e mëparshme.
12. Të mos çënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
13. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për të mundësuar përdorimin e burimit ujor nga subjekte të tjerë.
14. Të zbatojë parimet dhe kushtet të tjera për veprimtarinë të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e burimeve ujore.